

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE

Shtojca 13.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E
ANKIMIMIT

[30/01/2025]

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ose

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

“Gentian Sadiku” p.f (51%) & “Univers Promotions” sh.p.k (49%)

NIPT: L42314005A & K81324039M

Adresa: Rruga Tom Plezha, Kashar, Yzberisht & Mbikalimi i Rinasit, Kashar

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-28213-11-05-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në; Loti i dytë - Veshje Pune”.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 06.11.2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 78 datë 11 Nëntor 2024

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. "Arisa Konfeksion" shpk

J61828068L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **7,447,480 [shtatë milionë e katërqind e dyzetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë]** lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. "Bledi Loci" pf

L47401203N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **9,892,800 [nëntë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind]** lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. BOE "Gentian Sadiku p.f & Univers Promotions" shpk, NIPT L42314005A & K81324039M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **9,202,000 [nëntë milionë e dyqind e dy mijë]** lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "Arisa Konfeksion" shpk

J61828068L

1. Operatori ekonomik "Arisa-Konfeksion" shpk nuk ka plotësuar Shtojcën 9 - Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas formatit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor dhe sipas Dokumentave Standarte të Tenderit të publikuar për procedurën objekt ankimimi. Konkretisht, nga verifikimi i shtojcës të paraqitur nga ku operator ekonomik vihet re se, në **pikën B: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme nëse kërkohen**, në hapësirën për t'u plotësuar për makineri dhe mjete është bërë plotësimi vetëm i pohimit "Po", por nuk janë listuar makineritë e kërkuara sipas kriterit të vendosur në DST si vijon: "2.4.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje: (për secilin lot)

1 (një) makineri qëndisje;

1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjytjen e logove). **Shënim:** ***Kriteri 2.4.6 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin."

Operatori ekonomik ka ngarkuar Shtojcën 9 si më poshtë vijon:

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën	<u>Punonjës</u>



përgjegjësimit të plotë se:	Po [X] Jo []
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Nëse, po, numri i punonjësve: 142
	Profili i punonjësve Ing .Informatike, Modelist, Përgjegjese prodhimi, teknike qepje, rrobaqepese, Teknike prodhimi, prestar, punetore te gjithë makinave qepese, punetore pastrim fijesh, puntore paketimi, hekurosje, punonjes shperdarje & transporti, punonjes magazinimi, punonjes per menaxhimin e pritjes, punonjes per stampim, kontrollore cilesie.
	Makineri e mjete Po [x] Jo []
	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri <u>Saimir Bidaj</u>	
Firma <u>ARISA KONFEKSION</u> Rr. "5MAJI" TIRANE - ALB	

Sqarojmë se, referuar DST, **Udhëzime për Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë**, pika 2, b) “Operatorët ekonomikë të suksesshëm”, citohet shprehimisht: “b) *Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës*”. Referuar sa më sipër, operatori ekonomik “Arisa-Konfeksion” shpk nuk ka deklaruar asnjë të dhënë në hapësirën e dedikuar në DST për plotësimin nga ana e saj, të kriterit të sipërcituar. KVO gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, 19 “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në rast se operoret ekonomik pjesëmarrës në procedurë do të kishin paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]*”. KVO gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato.

2. Operatori ekonomik “Arisa-Konfeksion” shpk nuk plotëson pikën 2.4.2 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit në DST, ku citohet si vijon: “2.4.2 Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve të...

e ndarë sipas loteve si më poshtë:

Për Lotin 2: Veshjes së Punës përkatësisht *Kostum pune vere dok

(xhaketë+pantallona+kapele, bluzë me mëngë të gjata dhe të shkurtra)

(Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta”).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se, ky operator ka paraqitur dokumentin me emërtimin: “Analizat e Tekstileve,pdf”, në të cilën gjenden raportet e testimi për Kostum dok terikoton (xhaketë+pantallona) dhe Bluzë me mëngë të gjata dhe të shkurtra, përkatësisht raport testimi me nr.A2-241 datë 05.12.2024 dhe A2-242 datë 05.12.2024. Konstatohet se në këtë document, mungon raport-testimi për artikullin “Kapele”, si pjesë përbërëse e “Kostum pune vere dok”.

Sipas VKM-së Nr.1153 datë 24.11.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe Stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”, specifikimet teknike për artikullin “Kapele” janë si më poshtë:

“KAPELA

- Kapela duhet te jetë dok, blu e errët, e qepur me pe blu të errët;
- Materialet ndihmëse që duhen të përdoren për prodhimin e artikullit “kapelë” janë:
 - dok, blu e errët;
 - penj qepje, me ngjyrën e dokut;
 - stema e kapelës”.

Pra, operatori ekonomik ka dështuar në plotësimin e kriterit **2.4.2**, pasi nuk ka paraqitur Raport-testimi për artikullin “Kapele”. KVO gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen.

3. Nga verifikimi dhe kontrolli fizik i mostravë të dorëzuara nga operatori ekonomik, ditën dhe orën e hapjes së ofertave, rezulton se mostra për kostumin stof me përzierje (xhaketa, pantallona, kapele), pjesë e artikujve objekt prokurimi, nuk i është përmbajtur specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës, pasi ngjyra e kostumit për oficerët zjarrëfikës është përcaktuar në Shtojcën 6 të dokumentave të tenderit, blu e errët, ndërkohë që në mostra e dorëzuar pranë AK, në gjykimin e KVO është blu e hapur, e dokumentuar me foto si më poshtë:



KVO gjykon se, operatori ekonomik “Arisa-Konfeksion” shpk nuk plotëson pikën **2.4.7** të Kriereve të Vecanta të Kualifikimi, ku citohet si vijon: “2.4.7 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për të gjithë artikujt objekt prokurimi, si më poshtë: (për secilin lot), pika d) Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e

kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmërinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse shihet e nevojshme”.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomik “Arisa-Konfeksion” SHPK, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë te pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “Bledi Loci” pf

L47401203N

1. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën **2.4.7** të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit në dokumentat e tenderit, ku citohet si vijon: *“Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për të gjithë artikujt objekt prokurimi, si më poshtë: **pika a**) nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s’kualifikues”.* Rezulton se nga procesverbali i mbajtur nga KVO për paraqitjen e mostrave nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë, ditën dhe orën e hapjes së ofertave , operatori ekonomik “Bledi Loci” p.f nuk është paraqitur.

KVO gjykon se arsyeja e mësipërme është kusht direkt skualifikimi, për rrjedhojë dokumentat e tjera të paraqitura në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, si pjesë e ofertës së operatorit ekonomik “Bledi Loci” p.f, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorit mbetet e padryshuar. Sa më sipër, KVO konkludon njëzëri se Operatori Ekonomik “Bledi Loci” pf skualifikohet nga procedura e prokurimit me objekt: **“Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në; Loti 2: Veshje Pune”.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. BOE “Gentian Sadiku p.f & Univers Promotions” shpk, NIPT L42314005A & K81324039M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **9,202,000** [nëntë milionë e dyqind e dy mijë] lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR